



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 2/2024 regjistër (JD)
Datë 13.12.2024

Nr. 1 i vendimit
Datë 13.03.2025

VENDIM

**PËR MOSKALIMIN E ÇËSHTJES PËR SHQYRTIM
NË SEANCË PLENARE**

Kolegji i Shqyrtimit Paraprak, i përbërë nga gjyqtaret:

Ina RAMA	Relatore
Albana SHTYLLA	Anëtare
Natasha MULAJ	Anëtare

– mori në shqyrtim paraprak në dhomë këshillimi, më datë 13.03.2025, ora 13:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, çështjen e Juridiksionit Disiplinor (JD) nr. 2, datë 13.12.2024, që i përket:

KËRKUES: Tom Dedaj

SUBJEKTE

TË INTERESUARA: Këshilli i Lartë i Prokurorisë
Inspektori i Lartë i Drejtësisë

OBJEKTI:

1. Rigjykimin e çështjes së gjykuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, me vendimin nr. 01, datë 20.07.2020, që i përket kërkesit Tom Dedaj.
2. Shfuqizimin e vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, nr. {***}, datë 28.01.2022, për shkarkimin e prokurorit Tom Dedaj nga detyra.
3. Kthimin në detyrën e mëparshme të Prokurorit në Prokurorinë e Shkallës së Parë Dibër.
4. Dhënien e pagës nga data 30.11.2018 e deri në rifillimin e detyrës.

5. Dhënien e një shpërblimi të drejtë.

BAZA LIGJORE: Nenet 1, 2, 3, 4, 31, 32, 41, 42, 153, 154, 324, 327, 328, 329, 331, 445, 494, germat “c” dhe “d”, 495, 496 e vijues të Kodit të Procedurës Civile.
Vendimi nr. 13, datë 07.02.2022, i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për pezullimin nga detyra të ish-gjyqtarit A. H..
Vendimi nr. {***}, datë 24.01.2024, i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, që i përket shtetasit A. H..
Vendimi nr. {***}), datë 18.11.2024, i Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, që i përket shtetasit A. H..
Vendimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, që i përket shtetasit A. H..
Vendimi nr. 1, datë 20.07.2023, i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, që i përket shtetasit Tom Dedaj.
Vendimi nr. 1, datë 06.05.2021, i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, që i përket shtetasit Tom Dedaj.
Vendimi nr. 1, datë 04.10.2021, i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, që i përket shtetasit Tom Dedaj.
Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, neni 1 e vijues, nenet 100, 101, 102, 103, 104, 111, 115 e vijues, 118 e vijues, 157, 160, 161, 164, 166, 169, 172, 173, 174.
Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenet 6, 7, 15, 16, 17, 18, 23, 30, 31, 32, 33, 42, 43, 44, 49 e vijues, 131/f, 148/d.
Kodi i Procedurës Administrative neni 1 e vijues, nenet 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 18, 20, 22, 44, 46, 47, 49, 51, 55, 56, 58, 60, 61, 80, 81, 82, 83, 85, 93, 105, 108, 115, 116, 118, 121 e vijues, neni 125 e vijues.
Kodi i Punës.
Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, neni 59.
Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, neni 462.
Ligji nr. 8737/2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 1 e vijues, neni 26 e vijues, neni 34 e vijues.
Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.
Ligji nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, neni 276, pika 3 dhe neni 279, pika 5.
Vendimi nr. 34, datë 10.04.2017, i Gjykatës Kushtetuese.
Vendimi nr. {***}, datë 25.03.2022, i Gjykatës së Lartë, që i përket shtetasit A. K..
Ligji nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 27, 49, 51/a germa “b”, neni 71 pika 3, neni 72 e vijues.

Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar.

Vendimi i Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut *çështja Rrapo kundër Shqipërisë*.

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara.

Konventa “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe të profesionit” miratuar nga Konferenca e Përgjithshme e Organizatës Ndërkombëtare të Punës, neni 1 i saj.

Vendimi i Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut, nr. 37474/20, *Besnik Cani kundër Shqipërisë*.

Vendimi i Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut, çështja *Astraðsson kundër Islandës*.

Vendime të Gjykatës Kushtetuese.

Vendime të Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

Karta Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nenet 6, 11 dhe 14.

Kolegji i shqyrtimit paraprak, pasi dëgjoi gjyqtaren relatores Ina Rama, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi, z. Tom Dedaj, ka ushtruar detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër. Më datë 24.10.2016, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, nisur nga një program televiziv i transmetuar më datë 21.10.2016, në televizionin kombëtar Top Channel, ka regjistruar procedimin penal në ngarkim të kërkuesit për veprën penale të *korruptionit pasiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë*, parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal. Me urdhrin nr. {***}, datë 31.10.2016, Prokurori i Përgjithshëm vendosi pezullimin e kërkuesit nga ushtrimi i detyrës, deri në përfundim të hetimeve të procedimit penal.
2. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr. {***}, datë 26.07.2018, vendosi deklarinin fajtor të kërkuesit për kryerjen e veprës penale, për të cilën ishte ngritur akuza, dhe dënimin e tij me 3 (tre) vjet burgim. Në zbatim të neneve 30/1, 35 dhe 44/2 të Kodit Penal, gjykata ka dhënë si dënim plotësues heqjen e së drejtës së kërkuesit për të ushtruar funksione publike për 5 (pesë) vjet, ndërsa në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal, ka vendosur pezullimin e dënimit me burgim dhe vënien e të dënuarit në provë për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, me kushtin që gjatë kohës së provës mos të kryejë veprë tjetër penale.
3. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr. {***}, datë 06.11.2018, ka ndryshuar cilësimin ligjor të veprës penale, duke vendosur deklarinin fajtor të kërkuesit për

kryerjen e veprës penale të *moskallëzimit të krimit*, parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal dhe dënimit me 1 (një) vit burgim. Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal, Gjykata e Apelit vendosi pezullimin e dënimit me burgim dhe vënien e kërkuesit në provë për një periudhë 2 (dy) vjeçare, me kushtin që gjatë kohës së provës mos të kryejë veprë tjetër penale. Në aplikim të neneve 30/1, 35/2 dhe 44/2 të Kodit Penal, Gjykata e Apelit ka dhënë si dënim plotësues heqjen e së drejtës për kërkuesin për të ushtruar funksione publike për 1 (një) vit.

4. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, pasi u njoh me dy vendimet e cituara në paragrafët më sipër, si dhe me urdhrin e prokurorit N. S. për ekzekutimin e vendimit penal të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë, mbështetur në nenin 148/d, pika 2, germa “b” të Kushtetutës, me vendimin nr. {***}, datë 28.01.2019, vendosi:

1. *Shkarkimin nga detyra të prokurorit Tom Dedaj, bazuar në vendimin e formës së prerë nr. {***}, datë 06.11.2018, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë.*

2. *Me këtë vendim të njihet Prokurori i Përgjithshëm, Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër dhe z. Tom Dedaj.*

3. *Për të ndjekur dhe kontrolluar zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Sektori i Burimeve Njerëzore.*

4. *Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

5. Kolegji i Posaçëm i Apelit (në vijim “Kolegji”), në kuadër të juridiksionit disiplinor, është vënë në lëvizje për katër kërkesa të paraqitura nga kërkuesi Tom Dedaj. Konkretisht, për dy kërkesa me nr. regjistri 1/2019 (JD), datë 19.12.2019, nr. 1/2021 (JD), datë 26.02.2021, me të njëjtin objekt:

1. *Deklarimin të paligjshëm dhe shfuqizimin e vendimit nr. {***}, datë 28.01.2019, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për shkarkimin nga detyra të prokurorit Tom Dedaj;* 2. *Kthimin e paditësit Tom Dedaj në detyrën e mëparshme të prokurorit, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Dibër;* 3. *Dhënia e pagës paditësit Tom Dedaj nga data 28.01.2019 e në vazhdim.* 4. *Dhënien e një shpërblimi të drejtë paditësit Tom Dedaj në shumën 30.000.000 (tridhjetë milion) lekë.* 5. *Konstatimin e diskriminimit ndaj paditësit Tom Dedaj, etj.;* për kërkesën e tretë me nr. 6/2021 (JD), datë 09.07.2021, me objekt: *Rifillimin e gjykimit të çështjes;* si dhe për kërkesën e katërt me nr. regjistri 3/2023 (JD), datë 10.08.2023, me objekt: 1. *Rigjykimin e çështjes së gjykuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, me vendimin nr. 01, datë 20.07.2020, që i përket kërkuesit Tom Dedaj.* 2. *Shfuqizimin e vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, nr. {***}, datë 28.01.2022, për shkarkimin e prokurorit Tom Dedaj nga detyra.* 3. *Kthimin në detyrën e mëparshme të Prokurorit në Prokurorinë e Shkallës së Parë Dibër.* 4. *Dhënien e pagës nga data 30.11.2018 e deri në rifillimin e detyrës.* 5. *Dhënien e një shpërblimi të drejtë.*

6. Këto kërkesa, pas shqyrtimit, janë arsyetuar dhe zgjidhur me vendim nga Kolegji, si vijon:

Kërkesa me nr. regjistri 1/2019 (JD), datë 19.12.2019

6.1. Në bazë të nenit 21, pika 1 e ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar [në vijim “Ligji nr. 8577/2000], Mbledhja e Gjyqtarëve vendosi: *Kalimin për shqyrtim në seancë plenare publike të kërkesës së kërkuesit Tom Dedaj.* Në seancën plenare publike të datës 20.07.2020, mosparaqitja

e kërkuesit Tom Dedaj, edhe pse kishte marrë njoftim për zhvillimin e saj në datën 22.06.2020, mosparaqitja e ndonjë kërkesë për shtyrjen e seancës për ndonjë shkak të arsyeshem, mosparaqitja e parashtrimeve me shkrim në lidhje me objektin e gjykimit, u vlerësuan nga Kolegji si demonstrim i mungesës së vullnetit të kërkuesit Tom Dedaj për t'ia nënshtruar gjykimin e kërkesës së tij juridiksionit kushtetues të Kolegjit. Duke vlerësuar se edhe mungesa e një akti formal drejtuar Kolegjit ka ndodhur për shkaqe të ndërvarura nga zgjedhje procedurale të kërkuesit, në kuptim të parashikimit në nenin 31/b, pika 1 e ligjit nr. 8577/2000¹, Kolegji ka vlerësuar se situata faktike duhet të trajtohet si një heqje dorë nga kërkesa dhe me vendimin nr. 1 (JD), datë 20.07.2020, ka vendosur: *“Pushimin e gjykimit të çështjes nr. 1, datë 19.12.2019, të juridiksionit disiplinor, që i përket ankimit të z. Tom Dedaj kundër Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Prokurorisë së Përgjithshme”*.

Kërkesa me nr. regjistri 1/2021 (JD), datë 26.02.2021

6.2. Në këtë kërkesë, kërkuesi Tom Dedaj ka pretenduar se vendimi nr. {***}, datë 28.01.2019, i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për shkarkimin e tij nga detyra, është i padrejtë, i pabazuar në dokumente dhe prova, i kundërligjshëm, dhënë në mohim të të drejtës për një proces të rregullt ligjor të garantuar nga neni 42, pika 2 e Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNj-së. Në një fazë më herët, më datë 10.02.2021, në Kolegj ishte protokolluar një kërkesë e z. Dedaj për gjykimin e çështjes, ku kërkuesi parashtronte se Gjykata Administrative e Apelit dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë janë bërë pengesë për mosmarrjen në kohë të akteve, dhe se çështja e tij ka nisur me gjykimin në Gjykatën Administrative të Apelit, e cila një pjesë të kërtimeve të tij i kaloi për kompetencë pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe një pjesë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Kjo e fundit, për shkak të mosdakordësisë, e dërgoi çështjen në Gjykatën e Lartë. Ndërkohë që Kolegji i Posaçëm i Apelimit zhvilloi seanca duke marrë një vendim *absurd dhe të kundërligjshëm*, duke e pushuar gjykimin, sikur prej tij ishte bërë një kërkesë e tillë, ndërkohë që nuk ishte prezent e nuk kishte dijeni për sjelljen dhe vendimet e dhëna nga Kolegji. Po aty, z. Dedaj parashtron edhe që Gjykata e Lartë më datë 26.06.2020, me vendimin nr. {***}², ka marrë një vendim që përbën *një tjetër variant të kundërligjshëm*. Duke mos qenë dakord me sjelljen dhe vendimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i detyruar, ka paraqitur kërkesë për gjykim, duke bërë me dije se procesi i gjykimit për ankimin e tij ka filluar më datë 19.02.2019.

6.3. Kolegji i shqyrtimit paraprak, pas shqyrtimit të kësaj kërkesë, në mënyrë të përmbledhur, ka konstatuar dhe vlerësuar, si vijon:

- Kërkesa e z. Tom Dedaj, për gjykim, është regjistruar më datë 26.02.2021, dhe duke aplikuar çdo mënyrë garantiste për të vlerësuar kohën e paraqitjes së kërkesës, dhe duke abstraguat nga forma

¹ Ligji nr. 8577/2000, në nenin 31/b, pika 1, parashikon: *“Kërkuesi mund të heqë dorë nga kërkesa përpara fillimit të shqyrtimit të saj nga Gjykata Kushtetuese. Në këtë rast, Gjykata Kushtetuese vendos pushimin e gjykimit të çështjes”*.

² Në vendimin në fjalë, Gjykata e Lartë ka vendosur: (i) Përcaktimin e Gjykatës së Apelit Administrativ si gjykata kompetente për shqyrtimin e kërtimeve nr. 6, 7 dhe 8 të kërkesëpadisë; (ii) Përcaktimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, si gjykata kompetente për shqyrtimin e kërtimeve 4 dhe 5 të kërkesëpadisë; dhe (iii) Prishjen e vendimit nr. {***}, datë 22.10.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, lidhur me pjesën e konstatimit të mungesës së kompetencës funksionale për gjykimin e pikave 1, 2, 3 dhe 9 të padisë dhe pushimin e gjykimit të çështjes për këto kërtime të padisë.

dhe mangësitë e evidentuara në kërkesëpadinë e protokolluar më datë 21.10.2020 -- të bëra me dije qartësisht dhe në më shumë se një rast edhe kërkuesit -- nëse merret në konsideratë kjo datë, kërkesa rezulton të jetë paraqitur mbi 20 muaj nga dhënia e vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë për shkarkimin e kërkuesit nga detyra [më 28.01.2019]. Gjithashtu, kërkesa rezulton e paraqitur afërsisht 1 (një) vit pasi Gjykata Administrative e Apelit, pranë të cilës kërkuesi paraqiti padinë për të zgjidhur kërkesat e tij, dha vendimin që një pjesë e këtyre kërkimeve duhet të paraqiten pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit [më 22.10.2019].

- Edhe duke abstraguuar nga të gjithë këto elemente kohore me rëndësi, Kolegji ka theksuar se pjesa e kërkimeve të z. Dedaj, që lidhet me shfuqizimin e vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, objekt kërkimi, nuk ka qenë objekt kontestimi apo interpretimi mbi kompetencën në asnjë shqyrtim nga gjykatat e juridiksionit gjyqësor³, të ndodhur në përgjigje të kërkesëpadisë të kërkuesit gjatë harkut kohor nga 19.02.2019, datë kur kërkuesi pretendon se ka nisur procesin e gjykimit në gjykatat e juridiksionit gjyqësor. Përpos kësaj, togfjalëshi i shtuar në kërkimin e parë -- *për deklarimin e paligjshëm të vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë* -- paraqitet për herë të parë para Kolegjit të Posaçëm të Apelit, fillimisht më datë 21.01.2020 e në vazhdim edhe në kërkesën e regjistruar më datë 26.02.2021.

- Kërkuesi ka zgjedhur të mos ndjekë çështjen në përputhje me nenin 148/d të Kushtetutës, dhe përpos kësaj, edhe kur përpara depozitimit të kërkesës së datës 21.10.2020 iu dha mundësia për gjykimin në seancë plenare publike të kërkesës kundër vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhënë ndaj tij, vënë në lëvizje nga Gjykata Administrative e Apelit, për të cilën kishte marrë dijeni me njoftimin në datën 07.02.2020 dhe ri njoftimin në datën 19.06.2020, demonstroi mungesë të vullnetit për t'ia nënshtruar gjykimin e kërkesës së tij juridiksionit kushtetues të Kolegjit, analizuar gjerësisht në të gjithë këndvështrimet në vendimin nr. 1 (JD), datë 20.07.2020.

6.4. Në përfundim, bazuar në nenin 31, neni 31/a, pika 2, germa “ç”, si dhe nenin 71/a, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 8577/2000, Kolegji i shqyrtimit paraprak, me vendimin nr. 1 (JD), datë 6.05.2021, ka vendosur: *“Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare”*.

Kërkesa me nr. regjistri 6/2021 (JD), datë 09.07.2021

6.5. Në këtë kërkesë, kërkuesi Tom Dedaj, duke kërkuar rifillimin e gjykimit të çështjes dhe *deklarimin të paligjshëm dhe shfuqizimin e vendimit nr. {***}, datë 28.01.2019, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë për shkarkimin e tij nga detyra*, ka pretenduar se në vendimin e Kolegjit nr. 1, datë 20.07.2020, ka dy të pavërteta: (i) nuk është njohur për zhvillimin e asnjë seance në Kolegji; si dhe (ii) nuk ka paraqitur në Kolegji ndonjë kërkesë e aq më pak për pushimin e gjykimit.

6.6. Kolegji i shqyrtimit paraprak, pas shqyrtimit të kësaj kërkesë, ndër të tjera, në mënyrë të përmbledhur, ka konstatuar dhe vlerësuar, si vijon:

³ *Vendimi i Gjykatës së Apelit Administrativ të datës 22.10.2019, vendimi i së njëjtës gjykatë më datë 17.12.2019, me anën e të cilit nuk është pranuar rekursi z. Dedaj kundër vendimit për mungesë kompetence, vendimi i Gjykatës Administrative Tiranë të datës 09.03.2020, apo eventualisht vendimi i Gjykatës së Lartë datë 26.06.2020, vënë në lëvizje nga Gjykata Administrative Tiranë me rekurs.*

- Kërkuesi është vënë në dijeni që çështja gjyqësore e tij i ka kaluar për kompetencë Kolegjit që me dhënien e vendimit nr. {***}, datë 22.10.2019, të Gjykatës së Apelit Administrativ, ndaj të cilit kërkuesi ka bërë rekurs në Gjykatën e Lartë, duke kërkuar ndryshimin e vendimit të sipërcituar dhe gjykimin e çështjes po nga Gjykata e Apelit Administrativ, por me një tjetër trup gjykues dhe vazhdimin e gjykimit të kësaj çështje.
- Kolegji, në kuadër të informimit dhe transparencës të veprimtarisë së tij, nga momenti i regjistrimit të kësaj çështje të juridiksionit disiplinor, ka publikuar në faqen zyrtare të tij të dhënat e çështjes, palët e interesuara, përbërjen e Kolegjit të shqyrtimit paraprak, datën e zhvillimit të seancës publike, statusin e çështjes dhe në fund është publikuar si vendimi nr. 1 (JD), datë 20.07.2020, ashtu edhe vendimi nr. 1 (JD), datë 06.05.2021.
- Lidhur me pretendimin e kërkuesit se nuk ka paraqitur në Kolegji ndonjë kërkesë për pushimin e gjykimit, Kolegji, me vendimin nr. 1 (JD), datë 20.07.2020, ka arritur në përfundimin se situata faktike e përshkruar duhet të trajtohet si një heqje dorë nga kërkesa, në kuptim të parashikimit të nenit 31/b, pika 1 e ligjit nr. 8577/2000. Pretendimi i kërkuesit se nuk ka marrë përgjigje prej Kolegjit për shkresat me objekt marrje aktesh e dokumentacioni është vlerësuar se nuk qëndron, në kushtet kur me aktet e administruara provohet se në harkun kohor prej më shumë se gjashtë muajsh Kolegji ka shkëmbyer të paktën tre herë shkresa dhe përgjigje me të.

6.7. Në përfundim, bazuar në nenin 31, nenin 31/a, pika 2, germa “dh” e ligjit nr. 8577/2000, Kolegji i shqyrtimit paraprak, me vendimin nr. 2 (JD), datë 4.10.2021, ka vendosur: *“Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare”*.

Kërkesa me nr. regjistri 3/2023 (JD), datë 10.08.2023

6.8. Në këtë kërkesë, kërkuesi Tom Dedaj, përpos pretendimit për diskriminim për shkak të vendimmarrjeve të Kolegjit për moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, ka pretenduar se vendimi nr. 1 (JD), datë 20.07.2020, i Kolegjit, duhet konsideruar i marrë në kundërshtim me rregullat për gjykatën e krijuar me ligj, për shkak se në trupën gjyqësore të Kolegjit, ka qenë anëtar gjyqtari L. D., i cili, siç ka konkluduar edhe GjEDNj-ja, nuk ka plotësuar kushtet ligjore për të qenë gjyqtar. Në këtë mënyrë, kërkuesi ka kërkuar të rigjykohet kjo çështje në mbështetje të arsytimit të përdorur në *çështjen Cani kundër Shqipërisë*. Lidhur me afatin e paraqitjes së kërkesës në Kolegji, kërkuesi Tom Dedaj parashitroi se nuk ka një dispozitë që rregullon këtë rast, sipas tij, paraqitja e kërkesës është në përputhje me parashikimet e nenit 445 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenin 113 të Kodit Civil.

6.9. Kolegji i shqyrtimit paraprak, pas shqyrtimit të kësaj kërkesë, ka vlerësuar se shtrohen për zgjidhje dy çështje: (i) juridiksioni i Kolegjit të Posaçëm të Apelit për shqyrtimin e saj; (ii) verifikimi i plotësimit të kriterëve ligjore formale për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, të parashikuara në nenin 31/a, pika 2 e ligjit nr. 8577/2000. Në vijim, arsytimi dhe vlerësimi i Kolegjit lidhur me to.

- Lidhur me plotësimin e kriterëve formale, të parashikuara nga neni 31/b i ligjit nr. 8755/2000, ligji ku bazohet Kolegji kur vepron nën kornizën ligjore të Gjykatës Kushtetuese si një nga dy

kolegjet e kësaj gjykate, sipas përcaktimeve të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, është konstatuar se kërkitime të njëjta me ato të kërkesës objekt shqyrtimi, kërkuesi Tom Dedaj i ka paraqitur në Kolegj edhe në dy çështje të tjera të zgjidhura me vendimet e Kolegjit nr. 1 (JD), datë 06.05.2021 dhe nr. 2 (JD), datë 04.10.2021. Në këto kushte, *prima facie*, rezulton e provuar situata e parashikuar nga neni 31/1, pika 2, germa “dh” e ligjit nr. 8755/2000, rrethanë që përcakton vendimmarrjen e moskalimit për shqyrtim të kësaj çështje në seancë plenare.

- Nën dritën e parashikimit të posaçëm të nenit 71/c, pika 3 e ligjit nr. 8577/2000, sipas së cilit: *“Nëse Gjykata Kushtetuese ka vendosur më parë mbi një çështje, e cila është gjykuar nga një gjykatë ndërkombëtare dhe kjo e fundit ka konstatuar se janë cenuar të drejtat dhe liritë themelore të individit, si rrjedhojë e vendimit të Gjykatës Kushtetuese, subjekti i cenuar, në favor të të cilit ka vendosur gjykata ndërkombëtare, ka të drejtë t’i drejtohet me kërkesë Gjykatës Kushtetuese për rihapje të procesit të gjyqësor”*, Kolegji i shqyrtimit paraprak ka konstatuar se vendimi i GjEDNj-së në çështjen *Besnik Cani kundër Shqipërisë*, i referuar prej kërkuetit si baza ligjore mbi të cilën ai ka mbështetur kërkesën për rigjykimin e çështjes, nuk është relevant për zgjidhjen e kërkesës së tij.
- Përpos se në favor të kërkuetit Tom Dedaj nuk ka një vendim të një gjykate ndërkombëtare -- GjEDNj-së -- që ta legjitimojë në kërkesën për rihapje të procesit gjyqësor në Kolegj, kërkuesi e ka vënë në lëvizje dy herë Kolegjin, i cili, me vendimet përkatëse, ka disponuar për *moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare*. Në këto vendimmarrje, gjyqtari L. D. nuk rezulton të ketë qenë pjesë e Kolegjit të shqyrtimit paraprak, fakt i cili zhvlerëson në thelb pretendimin e kërkuetit se çështja e tij nuk është gjykuar nga një gjykatë e krijuar me ligj, siç jurisprudenca e GjDNj-së përcakton.
- Gjithashtu, pretendimi i subjektit se nuk ka dispozitë që parashikon afat për paraqitje të kërkesës për rishikim është vlerësuar prej Kolegjit i pabazuar, në referim të parashikimit të ligjit nr. 8577/2000, nenit 71/c, pika 4: *“Kërkesa për rihapje të procesit para Gjykatës Kushtetuese paraqitet brenda 4 muajve nga hyrja në fuqi e vendimit të gjykatës ndërkombëtare”*,

6.10. Në përfundim, bazuar në nenin 31, nenin 31/a, pika 2, germa “dh”, si dhe nenin 71/c, pikat 3 dhe 4, të ligjit nr. 8577/2000, me vendimin nr. 1 (JD), datë 10.11.2023, Kolegji ka vendosur: *“Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare”*.

II. Pretendimet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit

7. Kërkesa, me objekt si në hyrje të këtij vendimi, e nënshkruar nga kërkuesi Tom Dedaj dhe përfaqësuesi i tij me prokurë avokat Bexhet Lata⁴, është regjistruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 04.12.2024. Në vijim, kërkuetit dhe përfaqësuesit të tij i janë bërë me dije mangësitë në kuptim të parashikimeve të nenit 27, pika 2, germa “e” e ligjit nr. 8755/2000 [mosparaqitje e kopjeve të noterizuara të vendimeve objekt ankimi], si dhe i është kërkuar plotësimi i tyre në afatin e parashikuar në nenin 27, pika 5, të ligjit të sipërcituar. Brenda afatit, kërkuesi plotësoi mangësitë

⁴ Sipas Prokurës së Përgjithshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.10.2024, notere A. Xh. S..

e konstatuara duke paraqitur dokumentacionin në formën e kërkuar nga ligji⁵ dhe në vijim kërkesa u regjistrua në Regjistrin e Juridiksionit Disiplinor (JD) me nr. 2/2024, datë 13.12.2024.

8. Kërkuesi Tom Dedaj, pas ricitimit edhe në këtë kërkesë të vendimeve gjyqësore dhënë ndaj tij, të vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 36, datë 30.10.2020, që ka vendosur: *“Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare”*, si edhe të vendimit të Kolegjit nr. 1 (JD), datë 20.07.2020, shprehet se më pas i është drejtuar dy herë të tjera Kolegjit me kërkesën për rishikim, por me vendimet e marra Kolegji ka *përmbyllur një histori antikushtetuese, antiligjore dhe antinjerëzore ndaj tij*. Në vijim, kërkuesi shprehet se kërkesën e bazon në zhvillime e vendime të kohëve të fundit, duke sjellë në pah:

(i) Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr. {***}, datë 24.01.2024, ka vendosur deklarinin fajtor të të pandehurit A. H. dhe dënimin e tij me 1 (një) vit burg. Vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me vendimin e datës 18.11.2024. Për këtë arsye, Kolegji, me vendimin nr. 13, datë 07.02.2024, ka vendosur pezullimin e gjyqtarit A. H. nga detyra.

(ii) GjEDNj-ja, në çështjen *Besnik Cani kundër Shqipërisë*, ka konstatuar zhvillimin e një procesi jo të rregullt ligjor, për shkak se anëtar i trupit gjykues të Kolegjit ka qenë z. L. D., i dënuar penalisht nga Gjykata. Edhe në rastin e tij, siç rezulton nga përmbajtja e vendimit nr. 1, datë 20.07.2020, z. L. D. ka qenë anëtar i trupit gjykues.

(iii) Pavarësisht dënimit me një vendim gjyqësor të formës së prerë ndaj ish-gjyqtarit të Kolegjit, nga ky i fundit është pezulluar procedimi disiplinor ndaj këtij gjyqtari deri në shqyrtimin e rekursit të tij në Gjykatën e Lartë, duke e paguar atë me 50 % të pagës. Pasi Gjykata e Lartë vendos mospranimin e rekursit të z. L. D., Kolegji e shkarkon atë nga detyra me vendimin nr. {***} (JD), datë 09.12.2021.

(iv) Rrethanat e mësipërme janë fakte të reja të dala pas dhënies prej Kolegjit të vendimit nr. 1 (JD), datë 20.07.2020, dhe plotësojnë parashikimet e nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, për rishikimin e vendimeve nr. 1 (JD), datë 20.07.2020, nr. 1 (JD), datë 06.05.2021, si dhe nr. 1 (JD), datë 04.10.2021, të Kolegjit. Duke referuar parashikimet e nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, kërkuesi *pretendon se anëtari i trupi gjykues A. H. ka kryer një vepër penale që ka ndikuar në dhënien e vendimeve të sipërcituara dhe pjesëmarrja e tij si anëtar i trupit gjykues të Kolegjit vjen në kundërshtim me parashikimet e Kushtetutës dhe kriteret e ligjit nr. 84/2016*. Sipas kërkuesit, kjo situatë vjen në shkelje të nenit 6 të KEDNj-së, në lidhje me parimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj⁶.

(v) Duke referuar në qëndrimin e GjEDNj-së në çështjen *Cani kundër Shqipërisë*, në të cilën gjykata duke iu referuar parimeve dhe testit të parashikuar prej saj në çështjen *Astradsson kundër Islandës*, ka gjetur shkelje të nenit 6 të KEDNj-së, për shkak se një gjyqtar i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, që shqyrtoi çështjen e aplikantit Besnik Cani, është zgjedhur nga Kuvendi në shkelje të kriterëve ligjore, kërkuesi Tom Dedaj shprehet se në Islandë, në zbatim

⁵ Përcjellë me shkresën nr. {***} prot., datë 13.12.2024.

⁶ Shih paragrafin 26 të kërkesës.

të vendimit të GjEDNj-së për *çështjen Astradsson kundër Islandës* është ndërmarrë rishikimi i të gjithë vendimeve gjyqësore, ku anëtari/ët e trupave gjyqësore ishin emëruar në shkelje të nenit 6 të KEDNj-së. Sipas kërkesit, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës, në funksionin e tij për të mbikëqyrur zbatimin e vendimeve të GjEDNj-së në të drejtën e brendshme, konstatoi se rihapja e proceseve gjyqësore për ata individë që ishin gjykuar nga anëtarë të trupës gjyqësore të emëruar në kundërshtim me nenin 6 të KEDNj-së, përbënte zbatim të plotë të vendimit të GjEDNj-së. Në kuadër të këtyre parashtrimeve, kërkuesi potencon për zhvillimin e një procesi të parregullt ligjor dhe tejet diskriminues nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë me argumentet: - *nuk është thirrur dhe e gjithë procedura për shkarkimin e tij është zhvilluar në 5 minuta*; - *u shkelën të gjithë parashikimet ligjore për fillimin e procesit disiplinor*; - *nuk është njohur me materialet e dosjes*; - *nuk është thirrur Inspektori i Lartë i Drejtësisë*; - *ligjet nuk ekzistonin se ishin shfuqizuar*. Sipas kërkesit, një rast analog është shqyrtuar nga Gjykata e Lartë në rastin e shtetas A. K., ku, ndër të tjera, ka arsyetuar se: “[...] është në të drejtën e Këshillit të Lartë të Prokurorisë që të shqyrtojë rast pas rasti dhënien e masës disiplinore për kandidatët ose magistratët e dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale”. Sa i përket gjykimeve të kërkesave të tij në Kolegj, subjekti pretendon se u shkel haptazi ligji, pasi: - nuk është thirrur, janë falsifikuar dokumentet duke u shprehur në vendim se kërkuesi Tom Dedaj është thirrur në mënyrën e duhur sipas ligjit, por nuk është paraqitur; - me vendimin nr. 1, datë 20.07.2020, është vendosur pushimi i gjykimit me bazë ligjore që lejonte rihapjen e gjykimit me kërkesë të kërkesit, por në vijim për kërkesat e tij u gjetën hapësira ligjore për moskalim për shqyrtim në seancë gjyqësore, duke shkelur parimin e sigurisë juridike⁷.

(vi) Sa i përket afatit të paraqitjes së kërkesës, kërkuesi pretendon se është brenda afatit të parashikuar nga neni 445 i Kodit të Procedurës Civile “Prekluziviteti i ankimit”, që përcakton se: *“Ankimi në gjykatën e apelit dhe rekursi në Gjykatën e Lartë nuk mund të bëhen pasi ka kaluar një vit nga shpallja e vendimit. Kjo dispozitë nuk zbatohet kur pala në mungesë vërteton se nuk ka qenë në dijeni të procesit gjyqësor për shkak të pavlefshmërisë së njoftimeve”*.

III. Vlerësimi i Kolegjit të shqyrtimit paraprak⁸

9. Kolegji për shqyrtimin paraprak, në shqyrtimin e kërkesës së paraqitur nga z. Tom Dedaj, si në rastin e kërkesës pararendëse nr. 3/2023 (JD), datë 10.08.2023, të shqyrtuar dhe disponuar nga një tjetër trup gjykues, duke u gjendur para të njëjtit objekt ligjor kërkimi me ndryshimin e vetëm që lidhet me emrin e gjyqtarit, për shkak të të cilit kërkohet rigjykimi i çështjes, vlerëson se janë të njëjtat çështjet që shtrohen për zgjidhje, konkretisht:

⁷ Shih paragrafin 32 të kërkesës.

⁸ Kolegji i shqyrtimit paraprak u përzgjedh me shortin e hedhur në Mbledhjen e Gjyqtarëve të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në datën 17.12.2024 dhe përbërja e tij u njoftua kërkesit dhe përfaqësuesit të tij ligjor me shkresën nr. {***}, datë 05.12.2024, konfirmuar marrja dijeni përmes nënshkrimeve, si edhe në formë elektronike përmes e-mail, konfirmuar me përgjigjen e kthyer. Kërkuesi Tom Deda, me shkresën nr. {***} prot., datë 30.12.2024, ka paraqitur kërkesë për përjashtimin e anëtares së trupit gjykues Ina Rama nga gjykimi i çështjes. Kjo kërkesë u shqyrtua nga Mbledhja e Gjyqtarëve të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, e cila, me vendimin nr. {***}, datë 28.02.2025, vendosi rrëzimin e saj.

- (i) juridiksioni i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit për shqyrtimin e kërkesës;
- (ii) verifikimi i plotësisht të kriterëve ligjore formale për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, të parashikuara në nenin 31/a, pika 2 e ligjit nr. 8577/2000.

10. Kolegji, *së pari*, sjell në vëmendje se nga leximi harmonik i dispozitave që rregullojnë veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në kuadër të juridiksionit disiplinor, e konkretisht neni 179, pika 7 e Kushtetutës, rezulton se: [...] Kolegji i Apelimit shqyrton ankimet ndaj vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore, përkatësisht ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë [...]”. Ky parashikim kushtetues është detajuar më tej në nenin 5, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016”), sipas së cilit:

“[...] 3. Kolegji i Apelimit gjatë mandatit të tij, në përputhje me Kushtetutën, ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” dhe legjislacionit që rregullon çështjet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, ka juridiksion të shqyrtojë: [...] b) ankimet kundër vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë”.

11. Për sa më sipër, procedura për vlerësimin e kërkesës së kërkuarit dhe shqyrtimi i saj do të bazohet në parashikimet e ligjit nr. 8577/2000, duke marrë fillimisht në shqyrtim plotësimin e kriterëve formale të parashikuara në nenin 31/b të këtij ligji, të cilat janë parashikuar si një parakusht për kalimin për shqyrtim të një çështje në seancë plenare.

12. Nga faktet e referuara në pjesën hyrëse të këtij vendimi, rezulton se kërkuari Tom Dedaj, me kërkesën objekt shqyrtimi, ka paraqitur në Kolegj kërtime të njëjta me ato të kërkesave të zgjidhura me vendimet e Kolegjit nr. 1 (JD), datë 6.05.2021; nr. 2 (JD), datë 4.10.2021, si dhe nr. 1 (JD), datë 10.11.2023. Në këto kushte, *prima facie*, rezulton e provuar situata e parashikuar nga neni 31/1, pika 2, germa “dh” e ligjit nr.8755/2000, rrethanë që përcakton vendimmarrjen e moskalimit për shqyrtim të kësaj çështje në seancë plenare. Në drejtim të verifikimit të kushteve të parashikuara nga kjo dispozitë, Kolegji konstaton dhe vlerëson të evidentojë parashikimin e pikës 2, germa “dh” të tij, sipas së cilës: “Moskalimi i çështjes në seancë plenare vendoset kur [...] kërkimet e paraqitura në kërkesë janë objekt i një vendimi të mëparshëm të Gjykatës Kushtetuese ose rivendosja në vend e së drejtës së shkelur nuk është e mundur.[...]”.

13. Përpos sa më sipër, Kolegji verifikoi, gjithashtu, edhe nëse kërkesa e paraqitur prej kërkuarit gjendej nën parashikimin e posaçëm të nenit 71/c, pika 3 e ligjit nr. 8577/2000, sipas së cilit: “Nëse Gjykata Kushtetuese ka vendosur më parë mbi një çështje, e cila është gjykuar nga një gjykatë ndërkombëtare dhe kjo e fundit ka konstatuar se janë cenuar të drejtat dhe liritë themelore të individit, si rrjedhojë e vendimit të Gjykatës Kushtetuese, subjekti i cenuar, në favor të të cilit ka vendosur gjykata ndërkombëtare, ka të drejtë t’i drejtohet me kërkesë Gjykatës Kushtetuese për rihapje të procesi të gjyqësor”. Nën dritën e këtij parashikimi, Kolegji i shqyrtimit paraprak

⁹ Sipas ndryshimeve të miratuara me ligjin nr. 76/2016.

konstaton se vendimi i GjEDNj-së në *çështjen Besnik Cani kundër Shqipërisë*, e referuar prej kërkuarit si baza ligjore mbi të cilën ai ka mbështetur kërkesën për rigjykimin e çështjes, nuk është relevant për zgjidhjen e kërkesës së tij, sipas arsytimit të shtjelluar në detaj në vendimin nr. 1 (JD), datë 10.11.2023, për këtë pretendim. Në këtë situatë faktike, Kolegji detyrohet të ritheksojë qëndrimin e tij se i vetmi rast në të cilin kërkuari do të legjitimohej të drejtohej me një kërkesë për rihapje të procesit në Kolegj do të ishte ekzistenca e një vendimi të një gjykate ndërkombëtare - GjEDNj-së, në favor të tij.

14. *Së dyti*, sikundër pasqyruar më lart në këtë vendim, çështja për të cilën kërkuari kërkon rigjykim është e njëjtë në shkakun ligjor të saj, përderisa lidhet me pretendimin se qenia në trupin gjykues të një gjyqtari të Kolegjit, i cili është dënuar më pas me vendim penal, siç pretendohet të jetë rasti i gjyqtarëve D. dhe H., ka marrë përgjigje me anë të vendimit të Kolegjit nr. 1 (JD), datë 10.11.2023, ku asnjë prej gjyqtarëve, për të cilët kërkuari pretendon cenim të parimit të gjykatës së krijuar me ligj, nuk kanë qenë pjesë e Kolegjit të shqyrtimit paraprak, që ka dhënë vendimin për moskalimin e saj në seancë plenare. Pavarësisht se në kërkimin objekt shqyrtimi të këtij Kolegji, është përcaktuar si shkak për rigjykim dënimi penal i një gjyqtar tjetër i Kolegjit, i ndryshëm nga ai që i përkiste vendimit nr. 1 (JD), datë 10.11.2023, arsytimi dhe baza ligjore e përdorur për të mbështetur këtë pretendim rezulton të jetë e njëjtë, për pasojë Kolegji vlerëson se gjendemi para të njëjtave shkaqe ligjore që duhet të merren në konsideratë në mënyrë të përsëritur.
15. *Së treti*, Kolegji i shqyrtimit paraprak çmon të sjellë në vëmendje se neni 71/c, pika 4 e ligjit nr. 8577/2000, parashikon se: *“Kërkesa për rihapje të procesit para Gjykatës Kushtetuese paraqitet brenda 4 muajve nga hyrja në fuqi e vendimit të gjykatës ndërkombëtare”*. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit, për të referuar në parashikimet e neni 445 i Kodit të Procedurës Civile lidhur me afatin për paraqitje të kërkesës për rishikim, vlerësohen pa relevancë në rastin e kërkesës së paraqitur prej tij.
16. *Së katërti*, duke abstraguuar nga gjithçka që është arsyetuar në vendimin e cituar më lart edhe në paragrafët më sipër të këtij vendimi, në rastin objekt shqyrtimi, konstatohen disa rrethana të cilat ndonëse nuk përcaktojnë zgjidhjen e çështjes mund të renditen si një *obiter dictum* referuar rastit në fjalë, të cilat sërish do e bënin kërkesën e kërkuarit të pambështetur në ligj. Nga aktet e referuara prej kërkuarit, rezulton se gjyqtari A. H. është i dënuar sipas vendimit nr. {***}, datë 24.01.2024, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me vendimin e datës 18.11.2024. Pavarësisht këtyre vendimeve, gjyqtari Hajdari vijon të jetë gjyqtar i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, ndonëse i pezulluar nga detyra, rrethanë kjo e ndryshme nga ajo e prezantuar në rastin e gjyqtar D., në momentin e paraqitjes së kërkesës për rigjykim. Përveç kësaj, ky Kolegj vlerëson të sjellë në vëmendje qëndrimin se pretendimet që lidhen me dënime penale të gjyqtarëve të këtij Kolegji, për ngjarje të ndodhura më përpara dhe pa lidhje me ushtrimin e funksioneve të gjyqtarit në çështjet konkrete, nuk mund të jenë shkaqe që përfaqësojnë raste për rishikimin e vendimeve, edhe në kontekstin e rasteve të rishikimit të parashikuara në nenin 494 të Kodit të Procedurës Civile, nëse kjo dispozitë do të zbatohet prej Gjykatës Kushtetuese. Për pasojë, kjo kërkesë konsiderohet e pabazuar edhe në këtë këndvështrim.

17. *Së pesti*, Kolegji sjell në vëmendje se vendimet të cilat kërkohen të rigjyken prej kërkuesit janë në çdo rast vendime për moskalimin për gjykim në seancë plenare, të cilat janë marrë pas verifikimit të kushteve formale të paraqitjes së kërkesave të tij, e të cilat kanë derivuar në thelb që në vendimmarrjen e parë nga kalimi i afatit ligjor për paraqitjen e ankimit kundër vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, që ka shkarkuar nga detyra kërkuesin, mbështetur në dënimin e tij penal. Kjo rrethanë, e cila është konstatuar si një gjendje fakti, do të mbetet e njëjtë në çdo rast, si një fakt që ka ndodhur dhe nuk mund të modifikohet *post factum*, pavarësisht paraqitjes së kërkesave të reja të kërkuesit. Në këtë kontekst, prezenca e cilitdo gjyqtar në trupat gjykues të Kolegjit të shqyrtimit paraprak nuk mund të konstatojë një rrethanë tjetër fakti, që për më tepër as nuk pretendohet prej kërkuesit në çdo kërkesë të tij. Në këto kushte, kërkesa e tij, për të pasur një gjykim kushtetues për ankimin e tij kundër vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, do të haste gjithmonë pengesën formale të kalimit të afatit prekluziv të parashikuar prej nenit 71/a, germa “b” e ligjit nr. 8755/2000, me pasojë shuarjen e kësaj të drejte.
18. *Së fundmi*, Kolegji konstaton se kërkuesi Tom Dedaj i është drejtuar Kolegjit me disa kërkesa të cilat kanë synuar në çdo rast shfuqizimin e vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë për shkarkimin e tij nga detyra dhe rikthimin e tij në pozicionin e prokurorit. Të gjitha këto kërkesa janë konsideruar prej trupave të ndryshëm gjykues në kuadër të verifikimit paraprak, si të pakalueshme për gjykim në seancë plenare, për më tepër duke u mbështetur në arsyetim dhe shkaqe të njëjta¹⁰. Në këto kushte, konstatohet se kërkuesi ka përdorur në mënyrë abuzive të drejtën e tij për akses në gjykatë, ka treguar mungesë respekti dhe përgjegjshmërie në mënyrën se si i është drejtuar asaj, jo vetëm duke përsëritur disa herë të njëjtën kërkesë, për të cilën ka marrë të njëjtën përgjigje, por edhe duke shtrembëruar faktet e paraqitura para Kolegjit. Për sa analizuar më lart në këtë vendim, qartësisht rezulton se kërkesa e z. Tom Dedaj është e përsëritur në mënyrë abuzive. Përpos paraqitjes së kërkesave të përsëritura me të njëjtin shkak dhe objekt, të pavërtetat e pretenduara prej kërkuesit në kërkesat e tij, ndër to lidhur me mosmarrje dijeni për seancën gjyqësore publike apo mospërgjigje prej Kolegjit ndaj shkresave të tij, në këtë rast pasjellin aplikimin të nenit 31/c të ligjit nr. 8755/2000, që parashikon se: *“Gjykata Kushtetuese, kur konstaton se kërkuesi ose përfaqësuesi i tij ligjor paraqet kërkesë abuzive ose të përsëritur, për të njëjtin shkak dhe objekt, megjithëse ajo është shqyrtuar një herë nga Gjykata Kushtetuese, ose kur konstatohet se kërkuesi ose përfaqësuesi ligjor kanë fshehur ose shtrembëruar fakte dhe rrethana që lidhen me çështjen, urdhëron gjykitjen e tij në shumën nga 100 000 – 500 000 lekë”*.
19. Në përmbledhje të sa më sipëranalizuar, bazuar në përcaktimet e nenit 31/a, pika 2, germa “dh” dhe nenit 71/c, pikat 3 dhe 4 të ligjit nr. 8577/2000, Kolegji vlerëson se kërkesa e paraqitur nga z. Tom Dedaj nuk e kalon testin e verifikimit paraprak të këtij Kolegji, duke qenë se nuk plotëson kriteret ligjore për të qenë e vlefshme për kalimin për shqyrtim në seancë plenare.

¹⁰ Shih vendimet e Kolegjit, nr. 1 (JD), datë 20.07.2020, nr. 1 (JD), datë 06.05.2021, nr. 2 (JD), datë 04.10.2021, nr. 1 (JD), datë 10.11.2023.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i shqyrtimit paraprak të kërkesës, bazuar në nenin 31, nenin 31/a, pika 2, germa “dh”, nenin 31/c, pika 1, si dhe nenin 71/c, pikat 3 dhe 4 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

V E N D O S I:

1. Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.
2. Vendosjen e gjobës prej 100.000 lekësh, në ngarkim të kërkuarit Tom Dedaj.

Tiranë, më datë 13.03.2025.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

RELATORE

Ina RAMA

nënshkrimi